

**VENDIM**  
**Nr.286, datë 16.4.2004**

**PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujëtimin dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Elbasanit, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:

a) zona e fushës Kryezjarr-Shirgjan-Cërrik-Shals (ELK-22, ELK-1, ELK-40), që kullon me sipërfaqe 3688 ha;

b) zona e fushës Labinot-Elbasan-Bradashesh (ELK-2), që kullon një sipërfaqe 1365 ha;

c) zona e fushës Floq-Sulovë (ELK-18, ELK-3), që kullon një sipërfaqe 1020 ha;

ç) zona e fushës së Funarit (ELK-4), që kullon një sipërfaqe 50 ha;

d) zona e fushës së Fushë-Buall-Shushicë-Hajdaraj (ELK-5), që kullon një sipërfaqe 590 ha;

dh) zona e fushës Papër (ELK-7, ELK-14, ELK-11), që kullon një sipërfaqe 83;

e) zona e fushës Broshkë-Valas (ELK-8, ELK-9), që kullon një sipërfaqe 193 ha;

ë) zona e fushës Malasej-Shtërmën-Gostimë-Shtëpaj (ELK-15, ELK-16, ELK-20), që kullon një sipërfaqe 247 ha;

f) zona e fushës së Dumresë [ELK (B)-2, ELK(B)-3, ELK (B)-5, ELK (B)-7, ELK (B)-9, ELK (B)-9, ELK (B)-13], që kullon një sipërfaqe 1213 ha;

g) zona e fushës Domosdovë-Librazhd (LBK-1), që kullon një sipërfaqe 800 ha;

gj) pendët mbrojtëse nga përmytjet e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;

h) sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të kanaleve.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;

b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;

dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5 000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**